

U. KODI I SJELLJES PËR GJYQTARËT

ATP, Grand Slam Tournaments, ITF dhe WTA (secila një "Organ drejtues", dhe së bashku "Organet drejtuese"), si anëtare të Programit të Përbashkët të Certifikimit kërkojnë një standard të lartë të profesionalizmit nga të gjithë gjyqtarët e certifikuar (Kombëtarë dhe medistinktiv të Gjelbër, të Bardhë, të Brontë, të Argjendtë dhe të Artë) dhe të gjithë gjyqtarët e tjerë, (së bashku, "Gjyqtarët") që angazhohen në turnetë dhe ngjarjet ATP, Grand Slam, ITF dhe WTA ("Turnetë e Tenisit").

Të gjithë gjyqtarët janë automatikisht të detyruar nga, dhe duhet të veprojnë në përputhje me, këtë Kod të Sjelljes për Gjyqtarët ("Kodi"). Organet drejtuese do të vazhdojnë të kenë juridiksion mbi një Gjyqtar të pensionuar sipas Kodit dhe, siç është e zbatueshme, Rregulloret e Turneve dhe Kodet e Sjelljes të ATP, Grand Slam, ITF dhe WTA ("Rregullat e Organit Drejtues"), në lidhje me çështjet që ndodhin para pensionimit të tij / saj.

Ky Kod i lëshuar nga Organet drejtuese mund të ndryshohet herë pas herë.

A) Standardet e kërkuara

Nëse nuk përcaktohet ndryshe, standardet e kërkuara në vijim do të zbatohen në çdo kohë, përderisa një gjyqtar është, ose arsyeshëm konsiderohet të jetë, duke vepruar në cilësinë e tij / saj si gjyqtar i certifikuar, e që përfshinë, por nuk kufizohet:

- i) brenda zonave të vendngjarjes së një Turneu të Tenisit (që përfshinë çdo vendngjarje ose lokacion që lidhet me Turneun e Tenisit);
- ii) kur bie në kontakt me lojtarët, gjyqtarët, punonjësit e turneut, shikuesit ose punonjësit e Organit drejtues në lidhje me një Turne të Tenisit, pavarësisht nëse kjo ndodh në vendngjarje ose gjatë periudhës të atij Turneu të Tenisit;
- iii) kur kryen çfarëdo detyre të përcaktuar në Rregullat e Tenisit, Rregullat e Organit Drejtues ose Detyrat dhe Procedurat për Gjyqtarët; dhe
- iv) kur angazhohet nga një Organ drejtues, një turne ose ngjarje të ndërlidhur për të ofruar shërbime ad-hok siç është dhënia e trajnimit, ndihma për administrimin e gjyqtarëve, dhe çdo detyrë tjetër gjykimi.

1. Gjyqtarët duhet të jenë në gjendje të kënaqshme fizike për t'u mundësuar atyre t'i kryejnë detyrat e tyre.

2. Gjyqtarët duhet të kenë të pamur 20-20, natyrale ose të korigjuar, dhe dëgjim normal. Për më tepër, Gjyqtarët Ndërkombëtarë të Karrigës (Bronz, Argjend dhe Ar) duhet të paraqesin formularin e kryerjes së testit të syve tek "ITF Officiating" çdo vit, ndërkaq të gjithë gjyqtarët e tjerë të certifikuar duhet të paraqesin formularin e kryerjes së testit të syve tek "ITF Officiating" çdo tre vjet.

3. Gjyqtarët duhet të jenë në kohë për të gjitha ndeshjet të cilat iu janë caktuar.

4. Gjyqtarët duhet t'i kuptojnë, t'i nderojnë dhe t'i jetësojnë Rregullat e Tenisit, Detyrat dhe Procedurat e Gjyqtarëve, të gjitha Rregullat e Organit Drejtues për Turnetë e Tenisit në të cilat ata janë të angazhuar; Programin Anti-korrupsion të Tenisit, dhe të gjitha politikat e tjera të zbatueshme për gjyqtarët që mund të paraqiten herë pas herë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në Ndalimin e telefonit celular / Politikën për Orët e Mençura).

5. Gjyqtarët duhet të sillen me respekt ndaj gjyqtarëve të tjerë, punonjësve të turneut, shikuesve, lojtarëve, ndihmësve të lojtarëve dhe çdo personi tjetër që lidhet me çdo Turne të Tenisit.

6. Gjyqtarët duhet të mbajnë një nivel të lartë të higjienës personale dhe duhet të mbajnë një pamje profesionale në çdo kohë.

7. Gjyqtarët nuk duhet të pinë alkool, ose të përdorin marihuanë (përfshirë marihuanën mjekësore), ose ndonjë substancë tjetër, që mund të dëmtojë gjykimin e një personi, në 12 orë para çdo ndeshje të cilën ata e gjykojnë, si dhe në çdo kohë sa janë duke vepruar në cilësinë e tyre si gjyqtarë.

8. Gjyqtarët në çdo kohë duhet ta ruajnë paanshmërinë e plotë në raport me të gjithë tenistët dhe ndihmësit e tyre, dhe duhet të shmangin çdo konflikt real ose të perceptuar të interesit. Në mënyrë të veçantë, gjyqtarët nuk duhet të i) gjykojnë në asnjë ndeshje në të cilën kanë një konflikt real ose të perceptuar të interesit; ose ii) socializohen ose të bëhen intim me lojtarët, ose të hyjnë në marrëdhënie (biznesi, personale ose tjetër), ose të ndërmarrin ndonjë veprim - brenda ose jashtë fushës - që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tyre si një gjyqtar. Për shmangien e dyshimit dhe pavarësisht nga ato që u thanë më lart, gjyqtarët mund të marrin pjesë në ngjarje shoqërore në të cilat lojtarët janë të pranishëm, dhe mund të qëndrojnë në të njëjtat hotele si lojtarët, por nuk do të ndajnë dhomën e hotelit me asnjë lojtar të cilësdo moshë. Gjyqtarët duhet të deklarojnë të gjitha konfliktet e perceptuara ose reale të interesit me “ITF Officiating”, që administron Programin e Përbashkët të Certifikimit në emër të të gjithë anëtarëve të Programit të Përbashkët të Certifikimit.

Shënim: Shembuj të konfliktit të interesit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në të qenit një: tenist profesionist; mik, person i afërm ose ndihmës i një tenisti; Trainer Kombëtar i Tenisit; Kapiten i Ekipit Kombëtar të Tenisit; Drejtor ose organizator i turneut; ose punonjës, konsulent, kontraktues ose partner / bashkëpunëtor biznesi për një kompani që ka një interes komercial në tenis.

9. Gjyqtarët nuk duhet, në asnjë kohë, të diskutojnë thirrjet ose vendimet e bëra, nga vetë ata ose nga gjyqtarët e tjerë, me askënd përveç se me vetë ata gjyqtarë, mbikëqyrësin / gjyqtarin kryesor, Njësinë për Integritet të Tenisit, ose zyrtarin e Organit Drejtues përgjegjës për ndarje të drejtësisë.

10. Gjyqtarët do të respektojnë, në çdo kohë, ligjet penale në fuqi në të gjitha juridiksionet. Për shmangien e dyshimit, dhe pa u kufizuar me të sipërthënat, ky detyrim shkelet nëse një gjyqtar dënohet për, deklarohet i fajshëm për, ose nuk e konteston, një akuzë penale a aktakuzë, për çfarëdo shkelje në cilindo juridiksion.

11. Gjyqtarët në çdo kohë janë të detyruar dhe duhet të jenë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre që dalin nga Programi Kundëi-Korrupcion i Tenisit, i cili përfshin vijimin on-line të Programit për Mbrojtjen e Integritetit të Tenisit, dhe raportimin e çdo qasje korruptive tek Njësia për Integritet të Tenisit. Gjyqtarët nuk do të punësohen, ose ndryshe të shoqërohen ose të angazhohen, nga një kompani që pranon baste për turnetë profesionale të tenisit.

12. Gjyqtarët nuk duhet t’iu flasin shikuesve, ose të bisedojnë me ta, përderisa janë duke gjykuar një ndeshje, përveç siç është e nevojshme gjatë kursit të zakonshëm të gjykimin të një ndeshje.

13. Gjyqtarët nuk duhet, në asnjë kohë, të marrin pjesë në asnjë intervistë në media, ose takime me gazetarët, nga të cilat deklaratat e tyre në lidhje me ndarjen e drejtësisë në tenis mund të shtypen, transmetohen, postohen në mediat sociale, ose ndryshe përhapen publikisht, pa miratimin e Mbikëqyrësit / gjyqtarit kryesor.

14. Gjyqtarët nuk duhet, në asnjë kohë, të japin, të bëjnë, autorizojnë ose përkrahin komentet publike, përfshirë postimin e çfarëdo gjëje në ndonjë kanal të medieve sociale, e cila sulmon ose përçmon një turne, lojtar, gjyqtarët e tjerë ose Organit Drejtues, dhe të cilën gjyqtari e di, ose arsyeshëm do të duhej ta dinte, se do ta dëmtojë reputacionin ose interesat më të mira financiare, të turneut të tenisit, lojtarit, gjyqtarëve të tjerë ose Organit Drejtues, siç është e aplikueshme.

Pa cënuar dispozitat e tjera të këtij Kodi, shprehja e përgjegjshme dhe e matur e mendimit legjitim, nuk do të përbëjë shkelje të kësaj dispozite.

15. Gjyqtarët, në asnjë kohë, nuk do të bëjnë sjellje të padrejtë, joprofesionale, diskriminuese, kriminale ose joetike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përpjekjet për t'i lënduar, ose ndërhyrë me dashje tek gjyqtarët tjerë, lojtarët, punonjësit e turneut, ndihmësit e lojtarëve dhe shikuesit, si dhe sjellje të shkujdesshme ose moskokëçarëse, që ka gjasa të shkaktojë një lëndim ose ndërhyrje të tillë. Të gjithë gjyqtarët, gjithashtu, me sjelljen e tyre, duhet të japin një shembull të mirë për gjyqtarët e tjerë.

16. Gjyqtarët, në asnjë kohë, nuk do të bëjnë sjellje abuzive, qoftë ato fizike ose gojore, as të përdorin sjellje apo gjuhë kërcënuese, drejtuar gjyqtarëve të tjerë, lojtarëve, ndihmësve të lojtarëve, punonjësve të turneut, shikuesve ose anëtarëve të shtypit / medias.

17. Gjyqtarët, në asnjë kohë, nuk duhet të keqpërdorin pozitën e tyre të autoritetit ose kontrollit, dhe nuk duhet të dëmtojnë, të rrezikojnë, ose të përpiqen ndryshe të dëmtojnë ose rrezikojnë, mirëqenien psikologjike, fizike ose emocionale të gjyqtarëve të tjerë, lojtarëve, punonjësve të turneut, ose ndihmësve të lojtarëve.

18. Nuk do të tolerohen avancimet seksuale, ngacmimet apo abuzimi seksual, të çfarëdo lloji, ndaj gjyqtarëve të tjerë, lojtarëve, ndihmësve të lojtarëve, punonjësve të turneut, shikuesve ose anëtarëve të shtypit / medias.

19. Gjyqtarët duhet t'i bëjnë të gjitha kërkesat, lidhur me turneun, te Mbikëqyrësi / Gjyqtari kryesor ose Shefi i Gjyqtarëve.

20. Gjyqtarët duhet të zotohen të punojnë në një turne derisa të lirohen nga Mbikëqyrësi / Gjyqtari kryesor. Nëse një gjyqtarë ka pranuar detyrën për të gjykuar në një turne, ai / ajo nuk do të tërhiqet nga ajo detyrë para se të lirohet nga Mbikëqyrësi / Gjyqtari Kryesor, ose delegati përgjegjës për ndarje të drejtësisë i Organit Drejtues.

21. Të gjithë gjyqtarët kanë detyrim të vazhdueshëm për të shpalosur tek Programi i Përbashkët i Certifikimit, çdo shkelje faktike, të dyshuar ose të pretenduar të Kodit, për të cilën ata janë në dijeni, qoftë ajo shkelje e tyre ose e një gjyqtari tjetër. Dështimi për të raportuar përbën shkelje të Kodit.

22. Gjyqtarët duhet të veprojnë me ndershmëri në çdo kohë kur gjykojnë, dhe në të gjitha marrëdhëniet e tyre me Organin Drejtues, Njësinë për Integritet të Tenisit dhe gjyqtarët tjerë. Gjyqtarët duhet të bashkëpunojnë plotësisht me çdo hetim të bazuar mbi këtë Kod, Rregulla të Organit Drejtues për turnetë në të cilat ata gjykojnë, Programin Kundër - Doping të Tenisit dhe Programin Kundër - Korrupsion të Tenisit. Tutje, gjyqtarët nuk duhet (i) të japin informacione të pasakta, (ii) të lënë anash çfarëdo informacioni përkatës që kërkohet, ose (iii) qëllimisht të mashtrojnë ose të përpiqen të mashtrojnë organete tilla, zyrtarët e tyre ose gjyqtarët e tjerë.

B) Hetimi i shkeljeve të pretenduara

1. Shkeljet e pretenduara të këtij Kodi që ndodhin në vendngjarjen e një Turneu të Tenisit, duhet të raportohen menjëherë tek Delegati përkatës për ndarje të drejtësisë, siç specifikohet në Rregulloren E)2. më poshtë. Mbikëqyrësi / Gjyqtari kryesor në vendngjarje është përgjegjës për të përcaktuar nëse gjyqtari (ët), subjekt i shkeljes së pretenduar, do të pezullohet ose shkarkohet nga ajo ngjarje (por nuk do të ketë fuqinë për të pezulluar ose shkarkuar nga ndonjë ngjarje tjetër, përveç nëse udhëzohet kështu nga Delegati për ndarje të drejtësisë, pas vendosjes së një pezullimi të përkohshëm nën B)2 më poshtë ose si rezultat i një vendimi të lidhur me punësimin). Shkeljet e pretenduara, që ndodhin në kohë të tjera, duhet të raportohen me shkrim pranë “*ITF Officiating*”.

2. Kur Delegati për ndarje të drejtësisë vie në dijeni për një shkelje të mundshme të këtij Kodi, ai / ajo do ta shqyrtojë menjëherë çështjen dhe të përcaktojë nëse kërkohet hetim i mëtutjeshëm i shkeljes së pretenduar. Nëse po, Delegati për ndarjen të drejtësisë do të hetojë shkeljen e pretenduar, e cila do të përfshijë njoftimin me shkrim të gjyqtarit në fjalë për shkeljen e pretenduar dhe nën hetim, duke i dhënë gjyqtarit minimum dhjetë (10) ditë për të dhënë informacione ose prova të tilla siç kërkohet nga Delegati për ndarje të drejtësisë. Nëse jo, atëherë Delegati për ndarje të drejtësisë do të vazhdojë në përputhje me nenin B)5.

3. Delegatët për ndarje të drejtësisë kanë të drejtë të ndajnë informacione në lidhje me një hetim me Njësinë për Integritet të Tenisit, çdo Organ Drejtues (përkatës, duke përfshirë ITF-në në lidhje me Programin Kundër-Doping të Tenisit), dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Hetimet sipas këtij Kodi mund të qëndrojnë në pritje të përfundimit të një hetimi në kuadër të Programit Kundër-Korrupsion të Tenisit, Programit Kundër-Doping të Tenisit, Rregullat e Organit Drejtues, rregullore të tjera sportive të detyrueshme (të tilla si ato që zbatohen nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ose Komiteti Ndërkombëtar Paralimpik në ngjarjet kryesore të tyre) ose ligjet vendore (nga agjencitë e jashtme të zbatimit të ligjit). Qëndrimi i tillë mund të hiqet në çdo kohë me diskrecionin e Delegatit(ëve) për ndarje të drejtësisë. Çdo veprim (ose dështim për të ndërmarrë veprim) nga ndonjë organ i tillë, nuk do të cenohet fuqinë e Delegatit për ndarje të drejtësisë për të hetuar dhe ndjekur shkeljet e pretenduara të këtij Kodi. Për shmangien e dyshimit, një shkelje e pretenduar e Programit Kundër-Korrupsion të Tenisit do të hetohet dhe trajtohet nga Njësia për Integritet të Tenisit dhe do të jetësohet në kuadër të Programit Kundër-Korrupsion të Tenisit. Një shkelje e pretenduar e Programit Kundër-Doping të Tenisit do të hetohet dhe trajtohet nga ITF-ja dhe do të jetësohet në kuadër të Programit Kundër-Doping të Tenisit. Një shkelje e pretenduar e Rregullave të Organit Drejtues dhe / ose kushteve të punësimit ose angazhimit, do të hetohet dhe trajtohet nga Organi Drejtues përkatës.

4. Të gjithë gjyqtarët kanë për detyrë të bashkëpunojnë në hetimet për një shkelje të pretenduar sipas këtij Kodi (qoftë në lidhje me sjelljen e tyre ose të një gjyqtari tjetër), duke përfshirë ofrimin e dokumenteve dhe informacionit siç kërkohet nga Delegati për ndarje të drejtësisë, dhe të paraqitet si dëshmitar sipas kërkesës nga Kolegji Disiplinor ose Kolegji i Ankesave në çdo seancë të mbajtur në përputhje me këtë Kod. Dështimi për ta bërë këtë në vetvete mund të konsiderohet si shkelje e këtij Kodi.

5. Pas përfundimit të hetimit (nëse ka), Delegati për ndarje të drejtësisë përcakton nëse gjyqtari në fjalë ka për çfarë të përgjigjet. Nëse Delegati për ndarje të drejtësisë përcakton se ka për çfarë të përgjigjet, atëherë Delegati për ndarje të drejtësisë t'i dërgojë një njoftim me shkrim gjyqtarit ("Njoftimin e Akuzës"), me një kopje në Kolegjit Disiplinor, ku paraqet:

- a) shkeljen e pretenduar dhe një përmbledhje të fakteve në të cilat mbështetet akuza;
- b) provat mbi të cilat Delegati për ndarje të drejtësisë do të synonte të mbështetej në seancën dëgjimore përpara Kolegjit Disiplinor;
- c) sanksionet e mundshme për zbatim mbi bazën sipas të cilës është ngritur akuza;
- d) sanksionin/et e propozuar/a për ngarkim për akuzën;
- e) çështje që lidhen me pezullimin e përkohshëm të përshkruar në seksionin B)8; dhe
- f) të drejtën e gjyqtarit për t'iu përgjigjur njoftimit të akuzës brenda 10 ditëve, nga marrja e njoftimit, në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - i. ta pranojë akuzën(at), dhe t'i pranojë sanksionet e përcaktuara në njoftimin e akuzës;
 - ii. ta pranojë akuzën(at), por t'i kundërshtojë dhe / ose të kërkojë të zbusë sanksionet e përcaktuara në njoftimin e akuzës, ashtu që Kolegji Disiplinor t'i përcaktojë sanksionet në seancën dëgjimore; ose
 - iii. ta mohojë akuzën(at), ashtu që Kolegji Disiplinor ta përcaktojë akuzën, dhe (nëse e njëjta përkrahët) çfarëdo sanksionesh, në seancën dëgjimore.

Kur Delegati për ndarje të drejtësisë përcakton se nuk ka për çfarë të përgjigjet sipas Kodit, asnjë veprim tjetër nuk do të ndërmerret ndaj gjyqtarit në fjalë, i cili duhet të njoftohet për të njëjtën. Një vendim që nuk ka për çfarë të përgjigjet sipas Kodit, nuk do të ketë asnjë ndikim në ndonjë hetim ose

procedim në bazë të Programit Kundër-Korrupsion të Tenisit, Programit Kundër-Doping të Tenisit, ose Rregullave dhe rregulloreve të Organit Drejtues.

6. Në rast se nuk pranohet përgjigje ndaj njoftimit të akuzës brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se gjyqtari e ka pranuar akuzën(at), si dhe sanksionet e përcaktuara në njoftim.

7. Në rast se gjyqtari dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij / saj që të ketë seancë dëgjimore përpara Kolegjit Disiplinor, atëherë gjyqtari gjithashtu duhet të deklarojë se si ai / ajo i përgjigjet njoftimit të akuzës dhe të shpjegojë (në formë të përmbledhur) bazën për atë përgjigje.

8. Delegati për ndarje të drejtësisë, me hyrje të menjëhershme në fuqi, mund të pezullojë përkohësisht certifikimin e një gjyqtari në çfarëdo çasti, që nga pranimi një pretendimi për shkelje të këtij Kodi, e deri në përfundimin ose përmbylljen e rastit, kur ai / ajo konsideron, në diskrecionin e tij / saj të vetëm, se serioziteti i pretendimit dhe / ose provave të mbledhura në lidhje me atë pohim meritojnë një pezullim të tillë. Delegati për ndarje të drejtësisë do të njoftojë gjyqtarin në fjalë dhe Kolegjin Disiplinor për pezullimin e përkohshëm. Brenda 10 ditëve nga marrja e një njoftimi me shkrim të një pezullimi të përkohshëm, gjyqtari mund të kërkojë me shkrim në Kolegjin Disiplinor që pezullimi i përkohshëm të tërhiqet, duke dhënë arsyen(t) e kërkesës. Vendimi i Kolegjit Disiplinor mbikërkesës (nëse ka) do të jetë përfundimtar dhe detyrues. Të gjitha palët heqin dorë, në mënyrë të pakthyeshme, nga çdo të drejtë për çfarëdo forme të ankesës, shqyrtimit ose veprimit nga, ose në, çdo gjykatë me autoritet juridik në lidhje me një vendim të tillë. Kur pezullimi i përkohshëm nuk kundërshtohet nga gjyqtari, ose mbështetet nga Kolegji Disiplinor, ai do të komunikohet nga Delegati për ndarje të drejtësisë tek Organet Drejtuese përkatëse, ato Shoqata Kombëtare anëtare dhe / ose organizata të tjera përkatëse të tenisit, siç vlerësohen të nevojshme për qëllim të jetësimit.

C) Seancat dëgjimore para Kolegjit Disiplinor

1. Kolegji Disiplinor ka të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer funksionin e tij në mënyrë efikase dhe efektive. Në veçanti ai do të:

- nxjerrë udhëzime të mëtejshme, siç nevojiten për zhvillimin efikas të seancës;
- marrë këshilla ligjore dhe / ose të tjera profesionale, siç i vlerëson të nevojshme;
- emërojë një person, që e konsideron të përshtatshëm, për të vepruar si sekretar i tij në seancë;
- të mos jetë i detyruar me ndonjë rregull formal për pranimin e provave; dhe
- të sigurojë që gjyqtari të ketë një seancë dëgjimore të drejtë.

2. Delegati për ndarje të drejtësisë do t'i sigurojë Kolegjit Disiplinor një kopje të provave dhe parashtrësive në të cilat ai / ajo, dhe gjyqtari në fjalë, synojnë të mbështeten në seancën dëgjimore. Gjyqtari duhet të sigurojë materialin e tij / saj në anglisht, ose të ketë dhënë përkthimin në anglisht (të cilin Delegati për ndarje të drejtësisë ose Kolegji Disiplinor mund ta kërkojë të jetë i certifikuar).

3. Kolegji Disiplinor do të përcaktojë, nëse ka ndodhur një shkelje e këtij Kodi, bazuar në bilancin e mundësive. Kolegji Disiplinor do të gjykojë rastin në bazë të parashtrësive me shkrim dhe vetëm provave tashmë të dhëna, përveç nëse gjyqtari kërkon një seancë sy-më-sy. Seanca e tillë dëgjimore mund të mbahet me konferencë telefonike ose video-konferencë, në diskrecionin e Kolegjit Disiplinor.

4. Në rast se gjyqtari pranon akuzën(at), por kundërshton sanksionet e përcaktuara në njoftim, ose Kolegji Disiplinor konstaton se ka ndodhur një shkelje, Kolegji Disiplinor përcakton sanksionin(et) e duhur(a) që do t'i shqiptohen gjyqtarit. Në përcaktimin e sanksionit(ëve) të duhur, Kolegji Disiplinor mund të marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë por pa u kufizuar në (a) parashtrësat në emër të Organit Drejtues dhe të përfaqësuesve të tyre në ngjarjen e të cilit ka ndodhur shkelja e pretenduar; (b) seriozitetin e shkeljes; (c) efektin në integritetin e sportit; (d) çdo parashtrësë dhe provë e paraqitur për lehtësim ose për rëndim; dhe (e) periudhën e mbajtjes së cilitdo pezullim të përkohshëm.

5. Gama e sanksioneve që mund të shqiptohen janë në diskrecionin e Delegatit për ndarjen e drejtësisë dhe Kolegjit Disiplinor dhe mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në: (a) qortim dhe vërejtje për sjelljet e ardhshme; (b) pezullim të certifikimit për një periudhë të caktuar; (c) pezullim të përhershëm të

certifikimit; dhe, po ashtu, (d) tërheqjen e qasjes në, dhe akreditimit për, çdo ngjarje të tenisit të organizuar, të autorizuar ose sanksionuar nga Organet Drejtuese ose nga cila do Shoqatë Kombëtare.

6. Kolegji Disiplinor pa vonesë do të lëshojë vendimin e tij, me arsyetimet, tek gjyqtari, Delegati për ndarje të drejtësisë, Organet Drejtuese, Shoqata Kombëtare gjyqtarit, Njësiapër Integritet të Tenisit, dhe çdo organizatë tjetër të tenisit të cilën e konsideron përkatëse. Për shmangien e dyshimit, asgjë në këtë klauzolë nuk e ndalon një Organ Drejtues për ta publikuar rezultatin dhe / ose vendimin siç e sheh të arsyeshme.

7. Çdo vendim i Kolegjit Disiplinor i marrë në bazë të gjykimit si i fajshëm për, ose deklarimit i fajshëm ndaj moskontestimit të një akuze penale ose aktakuze për çfarëdo shkelje në cilindo juridiksion, siç përcaktohet në pikën A)10 të këtij Kodi do të jetë përfundimtar dhe detyrues dhe nuk mund të apelohej.

8. Nëse certifikimi i gjyqtarit është pezulluar në kohën e mbledhjes së ricertifikimit të vitit kalendarik përkatës, përpara se certifikimi i tij të rivendoset, Programi i Përbashkët i Certifikimit në diskrecionin e tij mund të kërkojë nga gjyqtari të paraqesë çdo korrespondencë përkatëse dhe mbështetëse për t'u marrë parasysh dhe për t'u shqyrtuar nga Programi i Përbashkët i Certifikimit. Programi i Përbashkët i Certifikimit ka të drejtë të marrë parasysh shkeljen e këtij Kodi, si dhe të gjithë faktorët e tjerë të rëndësishëm kur vendosin nëse certifikimi i gjyqtarit duhet të rivendoset, të ulet në nivel, ose të tërhiqet.

D) Ankesat

1. Në varësi të nenit C)7 më lart, një vendim që është bërë shkelje e këtij Kodi, mund të apelohej në Kolegjin e Ankesave brenda njëzet e një (21) ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Kolegjit Disiplinor.

2. Arsyet e ankimit në dispozicion të një gjyqtari do të kufizohen në pretendimet se Kolegji Disiplinor:

- a) nuk arriti t'i jepte gjyqtarit një seancë të drejtë;
- b) ka keqinterpretuar, ose ka dështuar që ta zbatojë mjaftueshëm këtë Kod; ose
- c) erdhi në një vendim të cilin, asnjë organ vendimmarrës i arsyeshëm dhe i mirëinformuar, nuk do të mund ta merrte.

3. Njoftimi i ankesës, një kopje e së cilit duhet t'i dërgohet Kolegjit Disiplinor dhe Delegatit për ndarje të drejtësisë, duhet të përfshijë arsyet e ankesës dhe të shpjegojë bazën e ankesës.

4. Kolegji Disiplinor duhet t'i sigurojë Kolegjit të Ankesave dosjen e plotë menjëherë pas pranimit të njoftimit për ankesë. Delegati përkatës për ndarje të drejtësisë do të parashtrijë përgjigje ndaj ankesës brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data kur ajo është pranuar.

5. Kolegji i Ankesave do të ketë të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer funksionin e tij në mënyrë efikase dhe efektive. Në veçanti ai do të:

- a) nxjerrë udhëzime të mëtejshme, siç nevojiten për zhvillimin efikas të seancës;
- b) marrë këshilla ligjore dhe / ose të tjera profesionale, siç i vlerëson të nevojshme;
- c) emërojë një person, që e konsideron të përshtatshëm, për të vepruar si sekretar i tij në seancë;
- d) të mos jetë i detyruar me ndonjë rregull formal për pranimin e provave; dhe
- e) sigurojë që gjyqtari të ketë një seancë dëgjimore të drejtë.

6. Kolegji i Ankesave do të procedojë vetëm me parashtrësar me shkrim, përveç kur Kolegji i Ankesave përcakton se seanca dëgjimore me gojë kërkohet për të siguruar drejtësi. Seanca e tillë dëgjimore mund të zhvillohet me konferencë telefonike ose video-konferencë, në diskrecionin e Kolegjit të Ankesave. Në varësi të urdhrin të mëtutjeshëm, Kolegji i Ankesave do të shpall vendimin e tij sa më shpejt që të jetë e mundur pas seancës.

7. Kolegji i Ankesave mund të konfirmojë, kthejë ose ndryshojë (me shqiptimin e sanksionit(eve) më të lehta ose më të rënda) vendimin që është subjekt i ankesës. Kolegji i Ankesave do të njoftojë menjëherë me shkrim gjatjet dhe të gjitha sanksionet e vendosura për palët. Për shmangien e dyshimit,

asgjë në këtë klauzolë nuk e ndalon një Organ Drejtues ta publikojë vendimin ashtu siç e sheh si të arsyeshme.

8. Vendimi i Kolegjit të Ankesave do të jetë përfundimtar dhe detyrues dhe nuk mund të apelohet tutje. Të gjitha palët heqin dorë, në mënyrë të pakthyeshme, nga çdo të drejtë për çfarëdo forme të ankesës, shqyrtimit ose veprimit nga, ose në, çdo gjykatë me autoritet juridik në lidhje me një vendim të tillë.

E) Të ndryshme

1. Përveç siç përcaktohet në Seksionin X, çdo sanksion i imponuar sipas këtij Kodi do të njihet dhe zbatohet automatikisht nga të gjitha Shoqatat Kombëtare dhe organizatat e tjera të tenisit.

2. Për qëllime të këtij Kodi:

- a) për rastet që përfshijnë Gjyqtarët Kombëtarë, dhe ata me distinktiv të Gjelbër dhe të Bardhë, Delegati për ndarje të drejtësisë do të jetë Kryeshefi i ITF-së për Ndarje të drejtësisë ose i emëruari i tyre. Kolegji Disiplinor do të përbëhet nga Kolegji i Brendshëm i ITF-së për Shqyrtime ndërkaq Kolegji i Ankesave do të përbëhet nga Tribunali i Pavarur i ITF-së. Rregullat e këtij kolegji dhe të këtij tribunali, merren si të përfshira këtu, me vetë faktin që janë përmendur, dhe mund të shkarkohen nga www.itftennis.com. Në rast të ndonjë konflikti midis këtyre rregullave dhe Kodit, rregullat e Kolegjit të Brendshëm të ITF-së për Shqyrtime dhe Tribunalit të Pavarur të ITF-së do të mbizotërojnë këtë Kod; dhe
- b) për rastet që përfshijnë gjyqtarët me distinktiv Bronz, Argjend dhe Ar, Delegati për ndarje përkatëse të drejtësisë do të jetë personi i emëruar si i tillë nga Organi Drejtues sanksionues i ngjarjes në të cilën ndodhi shkelja e pretenduar (që mund të jetë një person i vetëm që zakonisht kryen atë rol, ose një alternativë për një rast specifik, siç e sheh të përshtatshme Organi Drejtues). Kur shkelja e pretenduar ka ndodhur ose ishte jashtë vendngjarjes, Delegati i duhur për ndarjen e drejtësisë do të dakordohet nga shumica e Delegatëve për ndarje të drejtësisë të Organeve Drejtuese. Kolegji Disiplinor do të përbëhet nga Delegatët për ndarje të drejtësisë të Organeve Drejtuese, ose të emëruarin e një pale të tillë në rast të një konflikti interesi ose pengesë tjetër ndaj pavarësisë ose paanshmërisë së asaj pale. Kolegji i Ankesave do të përbëhet nga katër (4) persona, të emëruar nga secili Organ Drejtues në fillim të çdo viti, të cilët nuk do të marrin pjesë në hetime ose veprime para Kolegjit Disiplinor.

V. LIGJI QEVERISËS

1. Këto detyra dhe procedura dhe çdo mosmarrëveshje që lind nga, ose në lidhje me to (përfshirë çdo mosmarrëveshje ose pretendim në lidhje me detyrimet jokundërthënëse), do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjin anglez, pa marrë parasysh parimet e konflikteve ligjore që dalin.
2. Gjyqtari pranon të paraqesë çdo mosmarrëveshje, pretendim ose çështje të tjera që lindin në lidhje me këto detyra dhe procedura (përfshirë çdo mosmarrëveshje ose pretendim jokontraktor) për zgjidhjen e procesit të mosmarrëveshjeve të parashikuara në Kod, dhe për përjashtimin e ndonjë forumi tjetër.
3. Të mësipërmet nuk do të zbatohen për ndonjë mosmarrëveshje ose pretendim (përfshirë ndonjë mosmarrëveshje, pretendime kontraktuale ose jokontraktore) në lidhje me Rregullat e Organit Drejtues, Programin Kundër-Doping të Tenisit dhe Programin Kundër-Korrupsion të Tenisit, siç është e aplikueshme.

X. RECIPROCITETI

1. Delegati për ndarje të drejtësisë gëzon të drejtën të kërkojë nga Kolegji Disiplinor që të mbështesë, miratojë, ndryshojë ose prapësojë një pezullim ose sanksione të tjera të vendosura kundër një gjyqtari nga një Organ Drejtues ose një organizatë e tenisit tjetër përkatëse në përputhje me një proces tjetër disiplinor, (bie fjala një Shoqatë Kombëtare anëtaree ITF-së), i tillë që vlen për certifikimin dhe / ose akreditimin për çdo, të gjitha, ose një ngjarje specifike tenisi, të organizuar, autorizuar ose sanksionuar nga Organet Drejtuese.
2. Çdo Organ Drejtues, sipas nevojës, ka diskrecionin e vetë nëse do të njohë dhe zbatojë ndonjë vendim sipas këtij Kodi dhe ta konfirmojë, përvetësojë, ose të zgjasë një pezullim ose sanksion tjetër të vendosur në bazë të këtij Kodi.

PËRKTHYER NGA FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS

Shtëpia e Sportit
Rr. "Agim Ramadani" Nr. 253
10000 Prishtinë
www.tenniskosova.com

Lektor: Xhavit Kajtazi